



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2024

VENDIM

Nr. 5, datë 27.02.2024

PËR
MIRATIMIN E PLANIT VJETOR
TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2024

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 11, pika 1 dhe pika 4, shkronja “a” të Rregullores “Për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendim Qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 16, datë 30.04.2020, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k dhe “Deloitte Albania” sh.p.k, në cilësinë e audituesit të brendshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2024, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet bashkimi i operatorëve ekonomikë “Deloitte Audit Albania” sh.p.k dhe “Deloitte Albania” sh.p.k, në cilësinë e audituesit të brendshëm, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tianda Kaçi

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

